

EPOKA

ERE

E përditshme e pavarur
Viti XXII, nr. 6553
E martë, 8 mars 2022
çmimi 0.40 €

Kuvendi mban
seancë solemne
për nder të 7 Marsit | FAQE 6



Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com



facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR **ABBRUCH** GMBH
www.awr-abbruch.de


ORGANIZATAT E SHOQËRISË CIVILE KANË ORGANIZUAR TË HËNËN NË PRISHTINË
PROTESTË SOLIDARIZUESE NË MBËSHTETJEJE TË POPULLIT UKRAINAS | FAQE 4-5

KOSOVA SOLIDARIZOHET ME UKRAINËN



“Qëndrojmë me Ukrainën”,
“Paqe për Ukrainën” dhe
“Bota ka parë mjaftueshëm
luftëra” ishin disa prej
sloganeve të protestës
solidarizuese në
mbështetjeje të popullit të
Ukrainës. E pranishme në
këtë protestë ishte edhe
presidentja Vjosa Osmani, e
cila ka thënë se Kosova
qëndron fuqishëm me
popullin e Ukrainës siç ka
qëndruar përgjatë gjithë
historisë me popujt
liridashës anekënd botës.
Ndërkaq Dajana Berisha,
drejtoreshë e Forumit për
Iniciativa Qytetare, ka
theksuar se kjo protestë
është për ta treguar
rreshtimin e Kosovës karshi
vlerave perëndimore dhe
demokratike

OPINION



**MËSUESIT TIM JAKUP
KRASNIQI** F.7

Nga: Ferat SHALA

AKTUALE



**PS-ja FITON NË PESË BASHKI,
KOALICIONI I BERISHËS FITON NË
SHKODËR** F.5

**UNDP-ja LANSON PULSIN PUBLIK:
KONJUFCA PËLQEHET MË
SË SHUMTI NGA QYTETARËT** F.7

**REGJISTRI ZYRTAR I BARNAVE
NDIHMON NË NGRITJEN
E STANDARDEVE NË FUSHËN
E FARMACISË** F.3

EKONOMI



**LEJOHET VEPRIMTARIA
E KLUBEVE TË NATËS DHE
ORGANIZIMI I DASMAVE** F.8

**ÇMIMI I NAFTËS NË KOSOVË DO TË
ARRIJË NË 2 EURO** F.8

**Kongresisti amerikan
i kërkon Bidenit ta
ndihmojë Kosovën të
anëtarësohet në NATO**

FAQE 7



**RUSIA PO PËRGATITET PËR 'SULM
TË GJITHANSHËM' NË KIEV**

FAQE 2

RENOVA
PUTZ
Magedoni
Xhepçisht - Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 735
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

**Kolegji
BIZNESI**
www.kolegjbiznesi.com
info@kolegjbiznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERBANJIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

Rusia po përgatitet për 'sulm të gjithanshëm' në Kiev

Të hënën lufta Rusi - Ukrainë ka hyrë në ditën e dymbëdhjetë, ndërsa ende nuk ka shenja paqeje. Në mëngjesin e së hënës perëndimi i Kievit është goditur nga luftime të ashpra ajrore ruse

KIEV, 7 MARS - Zyrtarët e mbrojtjes në Ukrainë paralajmëruan se Rusia po përgatit forcat e saj për të nisur një sulm të gjithanshëm në kryeqytetin ukrainas, Kiev. Shtabi i përgjithshëm i ushtrisë

varr çdo ushtar që kryen krime luftarë në Ukrainë. Ai ka thënë se ushtarët rusë do të përballen me ditën e gjykimit për vrasje të qëllimshme. "Ne nuk do të falim. Nuk do të harrojmë. Do t'i ndëshkojmë të gjithë ata që



respektojnë "shqetësimet legjitime" të Ruisë për sigurinë. Pekini ka bërë thirrje për zgjidhjen e krizës përmes negociatave.

Ukraina pranoi 20 mijë raketa antitankë dhe kundërajrore

Ushtarët ukrainas kanë shpaktuar raketat antitankë "Javelin", të dorëzuara si pjesë e ndihmës së sigurisë së ShBA-së në Ukrainë, në aeroportin Boryspil, Kiev. Shtetet e Bashkuara dhe anëtarët e tjerë të NATO-s i kanë dërguar Ukrainës deri më tani 17 mijë raketa antitankë dhe 2 000 raketa kundërajrore "Stinger". Këtë e ka bërë me dije një zyrtar i lartë amerikan për CNN. Shumica e një pakete prej 350 milionë dollarësh të ndihmës për sigurinë amerikane tashmë është dorëzuar në Ukrainë, vetëm një javë pasi u miratua zyrtarisht nga Shtëpia e Bardhë.



Ministria e Mbrojtjes e Ruisë ka njoftuar se do të hapë korridore të reja humanitare nëpër disa qytete të Ukrainës për të lejuar evakuimin e civilëve. Sipas saj, armëpushimi do të bëhet në kryeqytetin Kiev, si dhe në qytetet Harkiv, Mariupol dhe Sumi.

Të gjitha këto qytete janë duke u sulmuar nga forcat ruse. Pala ukrainase nuk e ka konfirmuar ende armëpushimin.

Disa vende perëndimore, përfshirë Britaninë e Madhe dhe Shtetet e Bashkuara, i bënë thirrje Interpolit që ta pezullojë Rusinë nga organizata ndërkombëtare e zbatimit të ligjit.

Sipas sekretares së Brendshme britanike, Priti Patel, Mbretëria e Bashkuar, Shtetet e Bashkuara, Kanadaja, Australia dhe Zelanda e Re kërkuar "pezullimin e menjëhershëm të qasjes së Ruisë" në sistemet e Interpolit. "Veprimet e Ruisë paraqesin kërcënim të drejtpërdrejtë për sigurinë e individëve dhe për bashkëpunimin ndërkombëtar në zbatimin e ligjit", ka thënë Patel.

Kryeministri i Australisë, Scott Morrison, i kërkoi Kinës që t'u

bashkohet përpjekjeve për ta ndaluar pushtimin rus të Ukrainës.

Morrison paralajmëroi se bota është në rrezik të riformësohet nga një "hark autokracie". Kina, e cila ka lidhje të ngushta me Moskën, ka refuzuar ta cilësojë si pushtim sulmin rus ndaj Ukrainës, ndërsa u ka kërkuar vendeve perëndimore që t'i

ukrainase ka njoftuar se ushtria ruse ka grumbulluar tanke dhe njësi të motorizuara të këmbësorisë, që aktualisht janë në rrugë drejt qytetit të afërt, Irpin.

Në njoftim thuhet se komandantët rusë kanë furnizuar forcat e tyre me karburante të dërguara nga Bjellorusia. Zyrtarët ukrainas, po ashtu, thanë se ushtria ruse po i përqendron përpjekjet e saj edhe në rrethimin e qyteteve lindore, Harkiv dhe Çernihiv, dhe të qytetit jugor Mikollajiv. Presidenti i Ukrainës, Volodymyr Zelensky, ka paralajmëruar shtrinë ruse se forcat e tij "do të ndjekin deri në

kryejnë mizori në këtë luftë. Në tokën tonë. Nuk do të ketë vend të qetë në këtë tokë për ju, përveç varrit", ka thënë ai. Zelensky u kërkoi udhëheqësve perëndimorë që të ndërmarin veprime më të fuqishme kundër Moskës, duke thënë se "guximi i agresorit është një sinjal i qartë për Perëndimin, se sanksionet kundër Ruisë nuk janë të mjaftueshme".

Po ashtu, Zelensky në konferencën e tij ditore ka bërë thirrje për më shumë sanksione kundër Ruisë. Ai ka theksuar se pushtimi i vazhdueshëm i forcave ruse në Ukrainë tregon se Rusia nuk ka braktisur planet e saj kundër Ukrainës.

Shqipëria, pjesë e listës së vendeve armike të Ruisë

Rusia ka miratuar të hënën një listë të vendeve dhe territoreve që kryejnë veprime "jomiqësore" kundër Ruisë, kompanive dhe qytetarëve të saj. Në listën e shpallur renditen shtetet që vendosen ose iu bashkuan sanksioneve kundër Ruisë, pas fillimit të pushtimit në Ukrainë. Mes këtyre vendeve është edhe Shqipëria. Lista përfshin ShBA-në, Kanadanë, vendet e BE-së, Mbretërinë e Bashkuar, Ukrainën, Malin e Zi, Zvicrën, Shqipërinë, Andorrën, Islandën, Lihtenshtajnin, Monakon, Norvegjinë, San Marinon, Maqedoninë e Veriut. Nuk mungojnë as Japonia, Koreja e Jugut, Australia, Zelanda e Re, Singapori dhe Tajvani.



Kongresisti amerikan i kërkon Bidenit ta ndihmojë Kosovën të anëtarësohet në NATO

EPOKA
ERE

Qendresa RAMA

PRISHTINË, 7 MARS - Anëtari i Dhomës së Përfaqësuesve, demokrati Ritchie Torres, ka kërkuar nga presidenti i Shteteve të Bashkuara, Joe Biden, që Kosova të bëhet anëtare e NATO-s. Në një letër dërguar presidentit Biden dhe sekretarit amerikan të Shtetit, Antony Blinken, kongresisti Torres ka thënë se pas situatës së krijuar pas pushtimit rus të Ukrainës, duhet që Uashingtoni t'i ndihmojë Kosovës që të anëtarësohet në NATO. "Duke marrë parasysh pushtimin e paprovokuar rus ndaj Ukrainës, siguria në Evropë është kritike. Është parësore për sigurinë evropiane që ne të vazhdojmë dhe ta zgjerojmë partneritetin që kemi përmes NATO-s. Prandaj, si një prej aleateve më të fuqishme të ShBA-së, u bëjmë thirrje që t'i shtoni përpjekjet tuaja që të siguroheni që Kosova të pranohet në NATO si shtet anëtar", thuhet në letër. Ai ka përmendur sanksionet që Kosova ka vendosur ndaj Rusisë duke ndjekur shembullin e ShBA-së dhe Bashkimit

Evropian dhe ka thënë se Prishtina zyrtare nuk është imune nga agresioni rus. "Agresioni rus është, po ashtu, shqetësues për Kosovën dhe për shkak të raporteve veçse të tensionuara që ka me fqinjën e saj, Serbinë. Serbia vazhdon të largohet nga Perëndimi dhe të afrohet drejt idealeve ruse", ka shkruar Torres. Kongresisti Torres, po ashtu, ka përhëndetur hapat e ndërmarrë nga Kosova, duke përmendur kërkesën e ministrit të Mbrojtjes, Armend Mehaj, që Kosova t'i bashkohet aleancës ushtarake, por dhe vendimin e Kuvendit të Kosovës që qeveria t'i nisë negociatat për anëtarësim në Aleancë. "Ne pajtohemi me këto veprime. Përderisa Rusia vazhdon të sillt si një aktore joracionale dhe Serbia forcon raportet me Rusinë, duhet ta ndihmojmë aleaten tonë - Kosovën - që t'i bashkohet NATO-s. Në situatën e sigurisë që po zhvillohet shpejt në Evropë, ne duhet të qëndrojmë përkrah aleates sonë - Kosovës dhe të sigurohemi që ajo shpejt t'i bashkohet NATO-s si shtet anëtar", thuhet në fund të letrës së kongresistit Torres.



Pas shpërthimit të luftës në Ukrainë më 24 shkurt, liderët politikë në Kosovë kanë shprehur sërish qëllimin e tyre që Kosova të bëhet pjesë e Aleancës ushtarake. Gjatë kësaj jave presidenti i Turqisë, Recep Tayyip Erdogan,

tha se e përkrah Kosovën të bëhet pjesë e NATO-s. Ai foli kështu përkrah presidentes së Kosovës, Vjosa Osmani, që ishte në vizitë zyrtare në Ankara. Osmani disa herë ka potencuar se anëtarësimi në NATO është parakusht për paqe në rajonin e

Ballkanit Perëndimor. Por, presidenti i Serbisë, Aleksandër Vuçiq, më 28 shkurt tha se nuk mund të vlerësojë për momentin se sa real është rreziku që Kosova të bëhet anëtare e NATO-s por, sipas tij, situata "nuk është aspak naive".

Regjistri zyrtar i barnave ndihmon në ngritjen e standardeve në fushën e farmacisë

EPOKA
ERE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 7 MARS - Zëvendësministri i Shëndetësisë, Arsim Berisha, ka marrë pjesë të hënën në promovimin e regjistrit zyrtar të barnave në Republikën e Kosovës, edicioni i 6-të, i cili është plotësuar me barnat e reja të regjistruara deri në tetor 2021 dhe përmban 3 540 produkte të mbrojtura dhe 889 produkte gjenerike. "Regjistri i barnave, përveçse do ta ndihmojë komunitetin mjekësor në përgjithësi në Kosovë për t'i zbatuar praktikatat më të mira të administrimit të barnave të regjistruara në Kosovë, është edhe një shembull i mirë i bashkëveprimit midis Odës së Farmacistëve, Agjencisë së Kosovës për Pajisje dhe Produkte Mjekësore, Shoqatës së Farmacistëve dhe Profesionistëve nga Fakulteti i



Mjekësisë për t'i përditësuar të rejtat sa iu përket barnave të regjistruara në Republikën e Kosovës", ka thënë zëvendësministri Berisha. Ai ka theksuar se promovimi i Regjistrit

6 të barnave do të ndihmojë në ngritjen e standardeve në fushën e farmacisë, ndërsa mjekët familjarë dhe specialistët e fushave të ndryshme do të kenë para vetes një pasqyrë të qartë të

barnave të regjistruara dhe kjo do ta mundësojë përshkrimin racional të tyre. Kurse kryetari i Odës së Farmacistëve të Kosovës, Arianit Jakupi, ka thënë se AKPPM-ja

dhe OFK-ja do të shpërndajnë falas këtë regjistër për të gjithë farmacistët përgjegjës të barnatoreve që t'u shërbejë atyre në praktikën e përditshme në barnatore, në mënyrë që të kenë informata të sakta lidhur me barnat e regjistruara në Republikën e Kosovës. Regjistri do t'u shpërndahet falas edhe mjekëve familjarë dhe specialistë, rreth 1 000 ekzemplarë, duke i njoftuar saktë se cilat barna janë të regjistruara në Kosovë. Ushtruesi i detyrës së kryeshëfit të AKPPM-së, Arian Ahmeti, ka theksuar se MSh-ja, AKPPM-ja, OFK-ja, Shoqata e Farmacistëve dhe Fakulteti i Mjekësisë do të punojnë për digjitalizimin e këtij regjistri. Krahas regjistrit të barnave 6 u promovua edhe revista farmaceutike nr. 2 që nxirret nga OFK-ja, me temën kryesore për këtë numër "Siguria e produkteve medicinale".

Në 24 orët e fundit janë shëruar 137 qytetarë nga Covidi

PRISHTINË, 7 MARS (ER) - Ministria e Shëndetësisë ka njoftuar se të hënën, prej 985 testimeve, 23 qytetarë kanë rezultuar pozitivë me virusin Covid-19. Gjatë 24 orëve të fundit është

shënuar një rast i vdekjes. Të hënën janë shëruar 137 qytetarë, derisa numri i përgjithshëm i të shëruarve është 222 508. Në total numri i rasteve aktive është 1 021.

Në 24 orët e fundit janë dhënë 95 doza të vaksinës kundër Covid-19. Prej fillimit të vaksinimit në të gjitha qytetet e Kosovës janë dhënë 1 815 802 doza të vaksinës.

Deri më sot 817 331 qytetarë janë vaksinuar me dozën e dytë. Deri më sot janë dhënë 98 155 doza përforcuese dhe doza të treta të vaksinës kundër Covid-19.





ORGANIZATAT E SHOQËRISË CIVILE KANË ORGANIZUAR TË HËNËN NË PRISHTINË PROTESTË SOLIDARIZUESE NË MBËSHTETJEJE TË POPULLIT UKRAINAS

Kosova solidarizohet me Ukrainën

“Qëndrojmë me Ukrainën”, “Paqe për Ukrainën” dhe “Bota ka parë mjaftueshëm luftëra” ishin disa prej sloganeve të protestës solidarizuese në mbështetjeje të popullit të Ukrainës. E pranishme në këtë protestë ishte edhe presidentja Vjosa Osmani, e cila ka thënë se Kosova qëndron fuqishëm me popullin e Ukrainës siç ka qëndruar përgjatë gjithë historisë me popujt liridashës anekënd botës. Ndërkaq Dajana Berisha, drejtoreshë e Forumit për Iniciativa Qytetare, ka theksuar se kjo protestë është për ta treguar rreshtimin e Kosovës karshi vlerave perëndimore dhe demokratike

Forumit për Iniciativa Qytetare, ka thënë se populli i Kosovës i di vështirësitë që po i kalon populli ukrainas. Ajo ka thënë se kjo protestë është për ta treguar rreshtimin e Kosovës karshi vlerave perëndimore dhe demokratike. “Ne jemi sot këtu përmes një gjesti simbolik, për ta shprehur solidaritetin e Kosovës në rrafshin njerëzor, institucional, të OJQ-ve, ndaj popullit të Ukrainës”, është shprehur Berisha.

E pranishme në këtë protestë

ishte edhe presidentja e Kosovës, Vjosa Osmani, e cila i ka falënderuar të gjithë për praninë mbi të gjitha organizatat e shoqërisë civile për këtë organizim që, sipas saj, edhe një herë dëshmojnë se Kosova qëndron fuqishëm me popullin e Ukrainës siç ka qëndruar përgjatë gjithë historisë me popujt liridashës anekënd botës. “Natyrshisht se ajo çfarë po përjeton populli i Ukrainës në këto momente na rikthen kujtimet e plagëve të rënda që janë

shkaktuar mbi secilin qytetar të Kosovës gjatë viteve ’90 nga regjimi gjenocidal i Serbisë. Prandaj, edhe i jemi bashkuar botës demokratike, u jemi bashkuar aleatëve tanë jo vetëm për ta dënuar agresionin rus mbi Ukrainën por, në të njëjtën kohë, për të kërkuar përgjegjësi për krimet që po i kryen kriminelin i luftës, diktatori Putin. Do të qëndrojmë të bashkuar, do të bashkojmë zërin dhe veprimet tona sikurse edhe deri më tani, dhe jam e bindur që sikurse në rastin e Kosovës në vitin ’99, edhe tani në Ukrainë në vitin 2022 do të triumfojnë liria dhe demokracia”, ka theksuar Osmani.

Sipas saj, Kosova me të gjitha kapacitetet është e gatshme të presë refugjatë nga Ukraina. “Që nga dita e parë e agresionit të Rusisë në Ukrainë e kemi iniciuar këtë çështje me institucionet relevante. Tashmë ju e dini që është miratuar edhe një rezolutë e Kuvendit të Kosovës, dhe institucionet tona kanë treguar gatishmëri që të gjitha ato kapacitete që i kemi dhe që janë ndërtuar në ndërkohë për pritjen e refugjatëve nga Ukraina t’i shfrytëzojmë. Në të njëjtën kohë, natyrshisht që këtë ua kemi bërë të ditur edhe shteteve të cilat tani kanë më shumë refugjatë, por edhe shteteve të tjera aleate. Për më tepër, Kosova ka treguar gatishmëri që t’u japë mbështetje

EPOKA E RE Mal QORRAJ

PRISHTINË, 7 MARS - “Qëndrojmë me Ukrainën”, “Paqe për Ukrainën” dhe “Bota ka parë mjaftueshëm luftëra” ishin disa prej sloganeve të protestës solidarizuese me popullin ukrainas që është mbajtur të hënën në Prishtinë.

Ukraina është nën pushtimin e Rusisë qysh më 24 shkurt.

Sipas Kombeve të Bashkuara, qindra njerëz janë vrarë dhe mbi 1.5 milion janë zhvendosur.

Në protestën në Prishtinë, që është organizuar nga disa organizata joqeveritare, kanë marrë pjesë qytetarë dhe përfaqësues të institucioneve të Kosovës dhe diplomatë të akredituar në Prishtinë.

Dajana Berisha, drejtoreshë e



PS-ja fiton në pesë bashki, koalicioni i Berishës fiton në Shkodër

TIRANË, 7 MARS (ER) - Zgjedhjet e pjesshme vendore të mbajtura në gjashtë bashki të Shqipërisë ditën e diel do t'u japin kandidatëve fitues një vit qëndrimi në postin e kryetarit të Bashkisë derisa të mbahen zgjedhjet e tjera vendore në rang vendi.

Partia Socialiste ka fituar në Dibër, Durrës, Lushnjë, Vorën e Rrogozhinë, ndërkaq koalicioni "Shtëpia e Lirisë", e drejtuar nga Sali Berisha, ka fituar bashkinë e Shkodrës. Kurse PD-ja, e drejtuar nga Lulzim Basha, është renditur e treta për nga numri i votave në zgjedhjet e mbajtura në këto gjashtë bashki.

Kryeministri i Shqipërisë, njëherësh edhe lider i PS-së, Edi Rama, ka folur për zgjedhjet e 6 marsit. Ai ka thënë se këto zgjedhjet i dhanë Partisë Socialiste as më shumë e as më pak se sa atë që e prisnin. "Pesë nga gjashtë bashkitë në garë me

një fushatë pa i ndezur motorët e qendrës dhe me një hendek votash nga rivalët edhe më të mëdhenj sesa tregonin projeksionet tona. Urime fituesve dhe faleminderit të gjithë atyre që u angazhuan për këtë rezultat, mbi të gjitha faleminderit zgjedhësve të cilët dje ushtruan pushtetin e tyre vendimmarrës në interes të komunitetit. Ne kemi fituar Dibrën, Durrësin, Lushnjën, Vorën e Rrogozhinën, me rezultate përtej parashikimeve më optimiste! Por sot lartësia e sfidës është ku e ku më shumë marramendëse sesa mirëqeverisja e këtyre bashkive dhe sesa të gjitha sfidat qeverisëse deri fare pak ditë më parë", ka thënë Rama.

Rezultati i zgjedhjeve të 6 marsit tregon se të paktën deri tani PD-ja renditet e treta në pesë nga gjashtë bashkitë ku u zhvilluan zgjedhjet.

Edhe këtë herë kryetari i PD-së,



Lulzim Basha, nuk e pranon humbjen dhe aq më pak të mendojë të japë dorëheqje. Në fjalën e tij para medieve u shpreh se kushdo që i kërkon të braktisë detyrën do të

zhgënjehet. "Nuk është koha t'u largohemi përgjegjësive. Por përgjigja jonë është një reformë edhe më e thellë. Do të krijohen instrumente për mendimin e lirë dhe t'u ofrojmë

njerëzve një shpresë, platformë dhe për ta nxjerrë vendin nga kriza. Kemi shumë faktorë që kanë vendosur të investojnë kundër interesit publik", ka thënë Basha.



dhe mikpritje edhe gazetarëve nga Ukraina, në mënyrë që ata jo vetëm të vendosen në Kosovë, por edhe të vazhdojnë ta kryejnë punën e gazetarisë dhe raportimit këtu nga një vend i sigurt, pra nga Republika e Kosovës. Gjithçka që është në dorën tonë e kemi bërë dhe do të vazhdojmë të bëjmë edhe më tutje brenda kapaciteteve që një shtet i vogël si Kosova i ka. Por, të jemi të qartë se është me rëndësi që zëri ynë të dëgjohej në çdo kënd të botës se çfarë ndodh kur diktatorët lehatohen dhe se sa e nevojshme është ndihma e aleatëve tanë perëndimorë dhe shteteve të tjera paqedashëse në raport me popullin e Ukrainës që tani po bombardohen nga ana e Rusisë", ka theksuar Osmani.

E para e vendit, po ashtu, ka bërë me dije se si institucione kanë komunikuar me ambasadat e

Ukrainës anekënd botës, sidomos në shtetet ku edhe Kosova ka ambasadat. "Ne natyrisht që kemi komunikuar me ambasadat e Ukrainës anekënd botës, sidomos në shtetet ku edhe Kosova ka ambasadat. Kemi dërguar mesazhet tona edhe tek institucionet qendrore të Ukrainës. Natyrisht që ata janë të vetëdijshëm për të gjitha masat që i ka ndërmarrë Republika e Kosovës në përkrahje të popullit të Ukrainës, si dhe të sovranitetit dhe integritetit territorial të këtij shteti. Po ashtu, janë të vetëdijshëm se cili është shteti në rajonin tonë, i cili po vazhdon të qëndrojë përkrah Putinit dhe Rusisë, dhe natyrisht ajo është Serbia", ka thënë presidentja Osmani.

Autoritetet në Kosovë kanë njoftuar se mund të strehojnë 20 gazetarë ukrainas për një

periudhë gjashtëmujore, duke u mundësuar atyre të punojnë nga Kosova.

Qeveria e Kosovës ka ndarë 150 000 euro për t'i mbuluar shpenzimet e gazetarëve, por ende nuk dihet se kur do të arrijnë ata. Po ashtu, Ministria e Punëve të Jashtme dhe Diasporës në Kosovë ka bërë me dije se do t'u ofrojë strehim familjarëve të ushtarëve ukrainas që shërbejnë në Kosovë në kuadër të misionit paqeruajtës të NATO-s, KFOR. Në misionin e KFOR-it shërbejnë 40 ushtarë ukrainas.

MPJD ka thënë se do të dorëzojë kërkesë në qeveri që të përgatitet për pranimin e 5 000 refugjatëve ukrainas.

Kosova, po ashtu, u është bashkuar sanksioneve të Shteteve të Bashkuara dhe Bashkimit Evropian kundër Rusisë.



Mësuesit tim Jakup Krasniqi

Nga: Ferat SHALA

Gjatë viteve '80, kur isha nxënës i mësimit fillor në vendlindjen time, Jakup Krasniqi ishte mësuesi im i lëndës së Historisë. Nga ai pata rastin të mësoj për veprimtarinë atdhetare të shumë personaliteteve tona kombëtare dhe për qëndresën heroike të popullit shqiptar ndër shekuj.

Gjatë vitit 1981, kur unë isha nxënës i shkollës së mesme, me Jakup Krasniqin u takuam në rrethana të tjera, si pjesë e organizimit të demonstratave për Kosovën Republikë, që u mbajtën në Komunën e Drenasit, ku ai vazhonte ta kryente punën e mësuesit, por edhe të kontribuonte në lëvizjen kombëtare për çlirim.

Pas këtyre demonstratave dhe angazhimeve, Jakup Krasniqi burgoset krahas shumë mësuesve të tjerë që ishin pjesë e lëvizjes kombëtare dhe vuan dënimin me burg për 15 vjet. Vitet '90 e gjejnë Jakup Krasniqin sërish në misionin për të kontribuar në arsim. Kësaj radhe



ai ishte në krye të angazhimeve për organizimin e arsimit paralel shqip në komunën e Drenasit. Falë angazhimit dhe punës së palodhshme të tij, arsimit shqip në Drenas dhe më gjerë u mbajt financiarisht dhe profesionalisht dhe ishte arma më e fortë e shqiptarëve të Kosovës gjatë kësaj periudhe kohore. Ai arriti që të mobilizojë përreth jo vetëm mësues, por edhe

intelektualë dhe shtresa të tjera të popullatës në procesin e organizimit të ilegales dhe në përgatitje të rezistencës së armatosur për liri. Edhe gjatë kësaj kohe kisha rastin dhe mundësinë të punoja dhe të veproja së bashku me Jakup Krasniqin në këto procese të rëndësishme për vendin. Me fillimin e luftës së UÇK-së, zëri i mësuesit Jakup Krasniqi

bëhet zëri i luftës çlirimtare të Kosovës. Në cilësinë e zëdhënësit të UÇK-së dhe anëtarit të Shtabit të Përgjithshëm, ai dha kontribut të çmuar në adresimin dhe në artikullimin e kërkesave politike të UÇK-së për liri dhe pavarësi. Edhe gjatë kësaj periudhe kohore pata mundësinë të jem krahar Jakup Krasniqit deri në përfundim të luftës çlirimtare. Pas luftës Jakup Krasniqi e

vazhdon kontributin për ndërtimin e vendit dhe për shpalljen e pavarësisë duke qenë bartës i shumë funksioneve të rëndësishme të institucioneve të Kosovës.

Misioni i mësuesit tim Jakup Krasniqi nuk ka përfunduar as sot. Ai po vazhdon të kryejë prapë një mision tjetër po aq të rëndësishëm dhe të shenjtë për Kosovën. Misionin për ta mbrojtur personalitetin e mësuesit luftëtar të UÇK-së, misionin për të vërtetuar as lufta jonë ishte e drejtë dhe çlirimtare, ishte luftë e shenjtë dhe që nuk mund të përbaltet nga askush.

Jakup Krasniqi përfaqëson, me plot kuptimin e fjalës, idealin e mësuesit atdhetar dhe të palëkundur i cili gjithë jetën e tij e vuri në shërbim të vendit, në shërbim të arsimit, në shërbim të lirisë dhe në shërbim të shtetndërtimit.

Mësuesi im Jakup Krasniqi, gëzuar Dita e Mësuesit! Qëndro i palëkundur ashtu sikur ke ditur të qëndrosh gjithmonë krenar përballë sfidave.

(Autori është deputet i Kuvendit të Kosovës)

Kuvendi mban seancë solemne për nder të 7 Marsit

PRISHTINË, 7 MARS (ER) - Në shënim të 7 Marsit, Ditës së Mësuesit, u mbajt seanca solemne e Kuvendit të Kosovës, e cila filloi me fjalimin e kryeministrit të Kosovës, Albin Kurti, në nderim të të gjitha figurave të kombit shqiptar e mësuesve që u angazhuan dhe kontribuuan në ngritjen e arsimit.

Teksa nisi fjalimin e tij në seancën e ftuar nga vetë ai për këtë ditë të veçantë për kombin shqiptar, kryeministri Kurti tha se mësuesi nuk është ai që na sjell dijen abstrakte dhe vetminë, por virtytin publik të lirisë, deri edhe dijen e vetëmohimit në emër të hapjes së një epoke të re. Këtë, shtoi më



tej ai, e bëri edhe Pandeli Sotiri në Korçë në fund të shekullit XIX, këtë e bëri edhe Shaban Jashari në Skenderaj një shekull

më vonë. "Dhe si çdo kombi, edhe ne na duhet një epope e arsimit, një epope që e shpall arsimin. Ashtu si epopeja që e

përkujtuam dje dhe pardje e sot, si epopeja e lavdishme që na shpalli vullnetin, po ashtu na lipset një epope që na e ngjall inteligjencën, vendosjen e vullnetit në racionalitet", veçoi kryeministri.

Duke përmendur të gjitha figurat më të ndritura kombëtare të Rilindjes, kryeministri u shpreh se në ndërtimin e shtetit të një populli të çliruar, emancipimi i inteligjencës vjen prej patriotizmit të mësuesit. "Le ta themi hapur, - vazhdoi ai, - duke thënë se profesionalizmi është bashkimi i inteligjencës me atdhedashurinë, me dashurinë për njerëzit". "Secili prej nesh kujton me endje në të shkuarën e tij një mësues që ia ka zgjuar

dashurinë për dijen dhe besimin në talent. Në kohë pushtimi kjo dashuri është më e thirrur, në kohë paqeje rrezikon të jetë më e shtirur. Eh pra, na nevojitet epopeja e arsimit", theksoi kryeministri Kurti.

Në Ditën e Mësuesit kryeministri Kurti foli edhe për hapat që duhen ndërmarrë qeveria dhe reformat që duhen bërë me qëllim ngritjen e cilësisë në arsim. "Qeveria dhe të gjithë organet administruese duhet të jenë të ndërgjegjshëm se sa më shumë mësues emancipues të kemi mes nesh, aq më shumë shoqëria është e garantuar prej despotizmit dhe racizmit, prej korrupsionit dhe mashtrimit", ka thënë Kurti.

Krasniqi: Duhet të punojmë më shumë për përmirësimin e mirëqenies së mësimeve

PRISHTINË, 7 MARS (ER) - Kryetari i Partisë Demokratike të Kosovës (PDK), Memli Krasniqi, ka takuar ish-mësuesen e vet, Igballe Haziri, me rastin e shënimit të Ditës së Mësuesit - 7 Marsit. Krasniqi u shpreh se në ecjen e Kosovës ndër vite mësimeve kishin një nga përgjegjësitë më të mëdha, sidomos mësuesit e viteve '80 dhe '90 që, përveç rolit të tyre primar për dhënie të dijes, u kujdesën që të mbanin gjallë dashurinë për kombin dhe lirinë. "Si një nxënës i asaj kohe i kujtoj me nostalgji ditët e shkollës dhe

e vlerësoj përherë punën e madhe të mësueses sime Igballe Haziri, të cilën e vizitua sot bashkë me Blerandin, për t'ia uruar Ditën e Mësuesit. Edhe sot e kësaj dite, sa herë e takojmë mësuesen Igballe, ajo na inkurajon që të punojmë çdo ditë për shtetin tonë, por sidomos për brezat e rinj. Dashuria dhe përkushtimi i saj ndaj nxënësve të shumtë që ka edukuar ndër dekada është shembull që duhet ndjekur nga secili në cilindo profesion që bën", ka thënë Krasniqi. Lideri i PDK-së ka thënë se

shoqëria jonë duhet të kujdeset më shumë për mësimeve. "Ndihej krenar që kam qenë pjesë e qeverive që kanë kontribuar për rritjen e mirëqenies së tyre dhe për përmirësimin e dukshëm të kushteve të punës në shkollat dhe universitetet tona. Por, duhet bërë edhe më shumë, sepse kemi obligim ndaj kontributit të pareshtur të mësuesve, arsimtarëve e profesorëve tanë. Gëzuar Ditën e Mësuesit të gjithë mësimeve që nëpër dekada e mbajtën gjallë arsimin shqip", ka thënë Krasniqi.



UNDP-ja lanson pulsin publik: Konjufca pëlqehet më së shumti nga qytetarët

PRISHTINË, 7 MARS (ER) - Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim (UNDP) në Kosovë ka lansuar të hënën edicionin e 21-të të përmbledhjes Pulsi Publik në një prezantim virtual të gjetjeve kryesore, ku janë anketuar 1 300 persona.

Edhe pse të gjeturat tregojnë një rënie të lehtë të nivelit të kënaqësisë me të gjitha institucionet e Kosovës, në përgjithësi ato mbeten më të larta se mesatarja gjatë viteve të kaluara.

Niveli i kënaqshmërisë me presidenten kap vlerën prej 55.2-përqindësh. Niveli i regjistruar i kënaqshmërisë me punën e kryeministrit është 53.2 për qind. Niveli i kënaqshmërisë me performancën e ekzekutivit kap vlerën 47.6 për qind. Niveli i kënaqshmërisë me kryetarin e Kuvendit 55.4 për qind, ndërsa kënaqshmëria me punën e Kuvendit të Kosovës 50.3 për qind.

Sipas këtij pulsi publik, ka pasur rritje të shkallës së kënaqshmërisë me Zyrën e Kryeprokurorit, me shkallë të



kënaqshmërisë prej 34-përqindësh.

Kënaqshmëria me drejtimin politik të Kosovës është rritur për 6 pikë përqindjeje (30.7 për qind) dhe paraqet nivelin më të lartë të kënaqshmërisë

të regjistruar ndonjëherë nga anketat e Pulsit Publik.

Indeksi i besueshmërisë ekonomike ka tejkaluar për herë të parë pragun, duke kapur vlerën 1.52 pikë.

Tri çështjet kryesore të

raportuara gjatë kësaj ankete ishin papunësia (26.7 për qind), varfëria (24.3 për qind) dhe mjedisi (10.1 për qind). Kjo është hera e parë që mjedisi identifikohet si një nga problemet kryesor në

Kosovë.

Problemet e hapësirës urbane dhe çmimet e artikuljeve esenciale janë ndër pesë çështjet kryesore me të cilat ballafaqohen qytetarët e Kosovës.

Gjithsej 77.6 për qind e të anketuarve (do të votonin për një parti të caktuar politike, ose një koalicion, nëse zgjedhjet qendrore do të zhvilloheshin në të ardhmen e afërt. Ndërkaq 51 për qind e të anketuarve deklaruan se Covid-19 ka pasur ndikim negativ në mirëqenien e tyre ekonomike.

Gjithsej 43.9 për qind deklaruan se ka ndikuar negativisht në shëndetin e tyre fizik dhe 50.7 për qind treguan se ka ndikuar në shëndetin e tyre mendor.

Gjetjet tregojnë rënie të lehtë të ndjenjës së sigurisë te të anketuarit, me 73.6 për qind që ndihen të sigurt kur janë jashtë. Të dhënat e zberthyer sipas gjinisë tregojnë se ndjenja e sigurisë është më e ulët te femrat (71.5 për qind) sesa te meshkujt (75.4 për qind).

Gërvalla: Kemi kërkuar nga KFOR-i mbylljen e hapësirës ajrore për Rusinë

EPOKA
ERE Albulena S. MAVRAJ

PRISHTINË, 7 MARS - Komisioni për Punë të Jashtme dhe Diasporë, i drejtuar nga Haki Abazi, kryetar, ka mbajtur të hënën mbledhjen e radhës, në të cilën për të raportuar lidhur me zhvillimet dhe veprimet pas fillimit të luftës në Ukrainë ishte e ftuar ministrja e Punëve të Jashtme dhe Diasporës, Donika Gërvalla.

Kryetari Abazi, lidhur me zhvillimet dhe veprimet pas fillimit të luftës në Ukrainë, theksoi se nga i gjithë kuadri i ngjarjeve që janë duke ndodhur, institucionet e Kosovës kanë bërë punë të jashtëzakonshme, duke u rreshtuar përkrah botës demokratike. Siç tha ai, i gjithë spektri i çështjeve dhe argumenteve është në anën e shtetit të Kosovës, për të qëndruar këtu ku jemi. "Është detyrë e jona institucionale të bëjmë atë që kemi bërë dhe të vazhdojmë që nga afër të qëndrojmë bashkë me Aleancën Euroatlantike, Bashkimin Evropian dhe botën demokratike në dënimin e dhunës dhe agresionit rus në Ukrainë", ka theksuar Abazi.

Sa iu përket zhvillimeve dhe veprimeve pas fillimit të luftës



në Ukrainë, ministrja Gërvalla para anëtarëve të komisionit paraqiti një ekspozitë lidhur me punën dhe aktivitetet e ndërmarra nga institucioni që ajo përfaqëson. Me këtë rast ajo theksoi se janë ndërmarrë masat e duhura dhe të nevojshme lidhur me rreshtimin, mekanizmat, sanksionet, si dhe veprimet e tjera parandaluese ndaj ndonjë rreziku eventual. Prandaj, sipas saj, nuk ka vend për panik rreth situatës së

krijuar.

Ministrja Gërvalla, po ashtu, theksoi se rreth aktualitetit të ndryshuar në përgjithësi, në zhvillimet në Evropë dhe rajon, Kosova shumë shpejt dhe shumë qartë është pozicionuar në krah të partnerëve dhe aleatëve të saj, botës demokratike dhe botës së lirë. Gërvalla, gjithashtu, ka thënë se kanë kërkuar nga KFOR-i që të bëhet mbyllja e hapësirës ajrore për Rusinë. "Kemi kërkuar nga KFOR-i

mbylljen e hapësirës ajrore për Rusinë. Komandanti i KFOR-it ka thënë se KFOR-i së bashku me NATO-n janë duke e shqyrtuar këtë kërkesë. Na është premtuar nga KFOR-i dhe Shtetet e Bashkuara të Amerikës që këtë kërkesë do ta marrin seriozisht", është shprehur ministrja Gërvalla. Ndërsa anëtarët e komisionit shtruan pyetje për ministrin Gërvalla, duke marrë kështu edhe përgjigje prej saj. Në këtë mbledhje kryetari

Abazi i ka informuar anëtarët e komisionit lidhur me vizitën zyrtare që ka realizuar në Republikën e Turqisë. Vizitën kryetari Abazi e ka cilësuar shumë të rëndësishme, duke theksuar se në kuadër të saj janë realizuar shumë takime konstruktive lidhur me raportet Kosovë - Turqi. Gjithashtu, anëtarët e komisionit në këtë mbledhje kanë shqyrtuar dhe miratuar planin e punës të komisionit për vitin 2022.

Çmimi i naftës në Kosovë do të arrijë në 2 euro

PRISHTINË, 7 MARS - Shtrenjtimi i derivateve nuk ka të ndalur në Kosovë. Çmimi i naftës dhe benzinës është duke u rritur për çdo ditë nga 8 deri në 10 centë. Çmimet e karburanteve tashmë kanë arritur mbi 1.61 euro, por naftëtarët paralajmërojnë se një litër naftë do të arrijë në 2 euro. Sipas kryetarit të Shoqatës së

Naftëtarëve, Fadil Berjani, çmimet sot kanë mbërritur deri në 1 euro e 61 centë. Berjani paralajmëron se me këtë trend të ngritjes së vazhdueshme çmimet pritet të arrijnë deri në 2 euro për një litër naftë. "Sot çmimet e derivateve në tregun e Kosovës sillen prej 1.55 deri në 1 euro 61 centë, ndërsa çmimet e furnizimeve sot janë

1.56 centë. Këto janë çmime ekstreme, lufta e ka bërë të veten, çmimet janë enorme të shtrenjta dhe janë duke u shtrenjtuar në çdo moment. Se a do të shkojë deri në 2 euro një litër naftë, trendi është duke treguar se do të rriten çmimet dhe do të arrijnë 2 euro, në Shqipëri veç ka mbërritur 2.20. Kështu pritet edhe në Kosovë", thekson ai.



Kurti nuk përmend shifra të sakta për Fondin e Sigurisë, thotë se vlera e mjeteve është shtatëshifrore



PRISHTINË, 7 MARS (ER) - Kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, ka thënë se deri më tani vlera e mjeteve të mbledhura në Fondin e Sigurisë është shtatëshifrore. Kurti ka shtuar se deri në fundjavë numri i donacioneve ka qenë katërshifror. "Ajo që unë di, numri i donacioneve për Fondin e Sigurisë deri në këtë fundjavë ka qenë katërshifrorë ndërsa numri i

mjeteve të mbledhura është shtatëshifror. Për shifra të sakta mund t'ju tregojë Ministria e Financave", ka thënë Kurti. Gjatë javës së kaluar është themeluar Fondi i Sigurisë. Kryeministri me rastin e themelimit të tij i kishte ftuar qytetarët e Kosovës, mërgatën dhe donatorë të tjerë të kontribuojnë për sigurinë e vendit. "Mjetet e mbledhura

financiare synohet të përdoren në përputhje me strategjinë e sigurisë shtetërore të Republikës së Kosovës që pritet të miratohet nga Qeveria e Republikës së Kosovës. Funksionimi i këtij fondi do të rregullohet me akte përkatëse procedurale dhe do të përdoret ekskluzivisht për qëllimin e përcaktuar nga qeveria", pati theksuar kryeministri Kurti.

Lejohet veprimtaria e klubeve të natës dhe organizimi i dasmave

PRISHTINË, 7 MARS (ER) - Nga 7 marsi lejohet veprimtaria e klubeve të natës si dhe organizimi i dasmave, ka njoftuar sekretari i Shoqatës së Gastronomëve të Kosovës, Arian Vranica. Sipas Vranicës, subjektet që menaxhojnë këto veprimtari janë të obliguara që të caktojnë një apo më shumë persona përgjegjës për të kontrolluar ndonjëherë nga

dëshmitë e cekura me vendimin e ri të Qeverisë së Kosovës për masat kundër Covid-19. "Nga sot, me datë 7 mars 2022, zyrtarisht lejohet veprimtaria e klubeve të natës si dhe organizimi i festivaleve, koncerteve, ekskursioneve, pelegrinazheve, dasmave, fejesave, ahengjeve familjare dhe shoqërore deri në 50 për qind të kapaciteteve, në të gjithë

territorin e Republikës së Kosovës. Subjektet që menaxhojnë këto veprimtari janë të obliguara të caktojnë një apo më shumë persona përgjegjës për të kontrolluar ndonjëherë nga dëshmitë e cekura me vendimin e ri", ka njoftuar Vranica. Javën e kaluar Qeveria e Kosovës ka lehtësuar masat kundër Covid-19, duke hequr kufizimin e lëvizjes.



AAK-ja kërkon të rriten pagat e mësimdhënësve

Shefi i grupit parlamentar i AAK-së, Besnik Tahiri, në një konferencë për medie ka thënë se mësimdhënësit presin sot nga kryeministri lajmin për Ligjin e Pagave.

PRISHTINË, 7 MARS (ER) - Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK) kërkon që kryeministri Albin Kurti t'i rrisë pagat e mësimdhënësve. Shefi i grupit parlamentar i AAK-së, Besnik Tahiri, në një konferencë për medie ka thënë se mësimdhënësit presin sot nga kryeministri lajmin për Ligjin e Pagave. "Sot janë afër 24 mijë mësimdhënës parauniversitarë me pagë mesatare prej 470 eurosh të cilët presin implementimin e Ligjit të Pagave. Seancat e tilla formale sikur kjo e sotmja nuk u bëjnë nder mësimdhënësve. Kryeministri gjatë seancës së sotme duhej t'ua komunikonte mësimdhënësve datën se kur

do t'i marrin pagat me rritje. Nëse kjo nuk ndodh, atëherë kjo seancë solemne është vetëm një mashtrim i radhës ndaj kësaj kategorie dhe kategorive të tjera që përfitojnë nga implementimi i Ligjit të Pagave", ka thënë Tahiri. Ai ka theksuar se arsimiti ka qenë shtylla e vetme e cila ka ruajtur dhe lartësuar ndjenjën se një ditë do ta gëzojmë shtetin e pavarur dhe besimin në një të nesërme më të mirë. "Kjo kategori e çmuar e shoqërisë nuk duhet të neglizhohet. Shteti duhet ta ruajë dinjitetin e saj. Lëri fjalimet e bukura e ngjarjet solemne, por rriti pagat e mësimdhënësve, kryeministër", ka deklaruar Tahiri.



Katër fqinjët e tjerë të Rosisë që i druhen pushtimit



Nga Thomas De WAAL
"Carnegie Europe"

Kush mund ta ketë radhën pas Ukrainës? Ndërsa forcat pushtuese ruse po depërtojnë më tej në Ukrainë, vendet e tjera post-sovjetike kanë arsye t'i frikësohen të ardhmes së tyre. Pesë vende përveç Ukrainës, Armenia, Azerbajxhani, Bjellorusia, Gjeorgjia dhe Moldavia, klasifikohen nga BE-ja si fqinjët e saj në Partneritetin Lindor.

Tre prej tyre kremtuan të mërkurën 30-vjetorin e anëtarësimit të tyre në Kombet e Bashkuara. Por ato gjenden aktualisht të bllokuar në një "zonë gri", jashtë BE-së dhe NATO-s. Ka shumë gjëra për të thënë mbi dështimet e qeverisjes dhe për institucionet e dobëta në të gjitha këto vende.

Por 3 dekada pas shembjes së Bashkimit Sovjetik, ato janë që të gjitha shtete sovraane me të drejta të plota. Paradoksi i tmerrshëm është se edhe në ditët më të këqija në vitet 1990, asnjë nga këto vende nuk u përball me sfidën e ekzistencës së saj, me të cilën po përballlet Ukraina në vitin 2022.

Presidenti rus Vladimir Putin nuk po na rikthen në vitin 1991. Përkundrazi ai po na dërgon prapa në vitin 1939, apo edhe 1918, kur një fuqi perandorake mund ta fuste pa shumë problem ushtrinë e saj në një shtet fqinj. BE-ja duhet ta ndryshojë menjëherë një politikë fqinjësie të përqendruar tek reformat, në një politikë që synon mbijetesën e këtyre vendeve si shtete.

Në këtë kuadër, vlen të merren

parasysh dobësitë e këtyre pesë vendeve dhe si mund të mbështetet secili prej tyre. Bjellorusia është de facto në rajon i Rosisë. Minsku është partneri i plotë ushtarak i Moskës në luftën e re që ka nisur.

Në mesin e kasaphanës që po ndodh në Ukrainë, është e lehtë të anashkalohet fakti që Rusia e ka aneksuar Bjellorusinë. Një vend me 9 milionë banorë e ka dorëzuar pavarësinë e tij. Por 18 muaj më parë, ai përjetoi një kryengritje demokratike që gati e rrezoi presidentin Alexander Lukashenko.

Sa ndryshe do të ishte situata, nëse ato protesta masive do të kishin pasur sukses? BE-ja duhet të vazhdojë të mbështesë opozitën e guximshme demokratike të Bjellorusisë, por gjërat aty do të duan kohë që të ndryshojnë. Rusia ka një ndikim të madh në Armeni, vend që është anëtar i blloqeve ushtarake dhe ekonomike të udhëhequra nga Rusia, Organizatës së Traktatit të Sigurisë Kolektive dhe Bashkimit Ekonomik Euroaziatik.

Po ashtu Rusia qeveris enklavën me shumicë armene të Nagorny Karabakh, pas përfundimit të luftës të vitit 2020 midis Armenisë dhe Azerbajxhanit. Kryeministri armen Nikol Pashinyan erdhi në pushtet duke synuan ta çojë Armeninë drejt Evropës. Në populizmin e tij donkishotesk, ai nuk i ngjan askujt aq shumë në hapësirën post-sovjetike sa presidentit ukrainas Volodymyr Zelensky.

Por Ukraina dhe Armenia, janë në anët e ndryshme të ndarjes gjeopolitike aktuale. Ishte një

arritje që Armenia arriti të abstenonte ndaj rezolutës të 2 marsit të Asamblesë së Përgjithshme të Kombeve të Bashkuara që denoncon pushtimin rus të Ukrainës.

Një ekspert armen e përshkruan kryeministrin si një "trofe të dobishëm për Putinin", si njeriun që u angazhua për zbatimin e marrëveshjes së armëpushimit të vendosur nga Rusia, e cila i dha fund luftës të vitit 2020. Por Rusia ka në dispozicion në Armeni shumë leva ekonomike dhe politike afatgjata që mund t'i përdorë, dhe shumë miq të dobishëm si ish-presidenti dhe lideri i opozitës Robert Kocharyan. Përmes Marrëveshjes së saj Gjithëpërfshirëse dhe të Partneritetit të Zgjeruar (CEPA), Bashkimi Evropian dhe organizatat e diasporës armene që e kundërshtuan Pashinyan për shkak të luftës së vitit 2020, duhet ta mbështesin tani hapur qeverinë armene të zgjedhur në mënyrë demokratike.

Azerbajxhani po mban një pozicion balancues midis Rosisë dhe Ukrainës. Presidenti Ilham Aliyev vizitoi në janar Kievin. Më pas u thirr në Moskë vetëm 2 ditë para pushtimit rus, për të nënshkruar me Putinin një marrëveshje "bashkëpunimi" tashmë të hartuar nga pala ruse. Pika e parë e marrëveshjes flet për integritetin territorial dhe "respektimin e parimeve të mosndërhyrjes në punët e brendshme të njëri-tjetrit". (Vini re se sa i pacipë është përdorimi i kësaj gjuhe normative, duke pasur parasysh atë që bëri Putin dy ditë më vonë).

Por Azerbajxhani është më i

prekshëm në fushën ekonomike. Marrëveshja e lidh me ngushtë Bakunë me Moskën, duke folur më shumë për bashkëpunimin ekonomik, gjë që mund ta shndërrojë Azerbajxhanin një strehë për kompanitë ruse që përpiqen të shmangin sanksionet perëndimore.

Dy vendet më të rrezikuara janë Moldavia dhe Gjeorgjia. E para është disi më me fat. Është gjeografikisht më pranë BE-së dhe më larg Rosisë. Me kushtetutë është neutrale, dhe qeveria pro-evropiane e Maia Sandu përballlet me një opozitë pro-ruse shumë të fortë, dhe tani me krizën humanitare teksa dhjetëra mijëra refugjatë ukrainas kanë hyrë tashmë në këtë vend.

Skenari më i frikshëm për moldavët, është nëse rusët vazhdojnë të përparojnë përgjatë bregut të Detit të Zi në Odesa, dhe trupat lidhen me ato që gjenden aktualisht në Transdnistria, provinca separatiste e Moldavisë e financiar dhe e armatosur nga Rusia prej 30 vjetësh.

Administrata në Transdnistria do të luajë një lojë me dy porta: mbështetje politike nga Moska nëpërmjet një force të vogël ushtarake ruse, dhe mbështetje nga Moldavia dhe BE si partneret e saj ekonomike. Rusia ka shumë pak interes për Transdnestrian në vetvete. Por mund të ketë një interes të fortë për të si një bazë e re ushtarake.

Ndërkohë, Gjeorgjia është në shumë mënyra e ngjashme me Ukrainën. Deklarata e Bukureshtit e vitit 2008, që krijoi për të dyja vendet një perspektivë jo aq të

qartë për anëtarësimin në NATO, i la ato në një situatë të mjegullt: pa një plan zyrtar për hyrjen në NATO dhe përballë një Rusie më armiqësore.


Në Tbilisi ka pasur prej ditësh protesta të mëdha në mbështetje të Ukrainës. Presidentja Salome Zurbishvili, po e mbështet Ukrainën duke krye një sërë vizitash në kryeqytetet evropiane. Kryeministri Irakli Garibashvili, ka qenë shumë më i ndrojtur duke refuzuar të dënojë hapur veprimin e Rosisë, sjellje që është kritikuar nga homologu i tij ukrainas.

Politika dikur shumë e suksesshme e qeverisë reformatore gjeorgjiane për refuzimin e sjelljes së Rosisë ka degraduar. Tbilisi ka aktualisht mosmarrëveshje si me Brukselin po ashtu edhe me Uashingtonin lidhur me hapat prapa që ka bërë në aspektin e demokracisë.

Dhe qasja e butë ndaj Rosisë, dhe mos-rreshtimi me aleatët e saj tradicionalë perëndimorë, mund ta vendosë në një situatë delikate. Për më tepër, lufta e ka inkurajuar opozitën, dhe po përkeqëson krizën e stërzgatur politike në vend.

Nëse Putini do të ketë ambicie për të marrë kontrollin e Gjeorgjisë, ai do ta bëjë këtë me shumë më pak sforcë se sa në Ukrainë. Mbështetja për Rusinë ndalet në kufijtë de facto të Abkhazisë dhe Osetisë së Jugut. Brezi i ri mezi e flet rusishten. Asnjë parti politike nuk embron bashkimin me Rusinë. Por siç po e shohim në Ukrainë, Putini mund të krijojë nga hiçi një shkas për të nisur një luftë të re.

Bota.al



QENDRA SPORTIVE
'BUJOËSIA'
TEL: 045/82 82 82

IJF-ja, krenare me xhudon e Kosovës, kërkon të ngrehen edhe sportet e tjera

PRISHTINË, 7 MARS - Federata Ndërkombëtare e Xhudos (IJF) është shprehur krenare me xhudistët e Kosovës për sukseset e arritura dhe për shpërblimet që morën së fundmi nga Komiteti Olimpik i Kosovës. Pak ditë më parë kampionia olimpikë Distria Krasniqi dhe kampioni evropian Akil Gjakova i fituan çmimet kryesore, ndërsa trajneri i vitit u zgjodh Driton Kuka. Për këto suksese të

xhudos së Kosovës IJF-ja po ndihet krenare, teksa ka kërkuar që edhe sportet e tjera të ngrihen. "Në Kosovë, një vend i cili sportin e xhudos e ka elitë, Distria Krasniqi, kampione olimpikë në kategorinë -48 kg dhe Akil Gjakova, kampion evropian, janë shpërblyer duke u zgjedhur sportistët e vitit dhe nga këtu ne ju njoftojmë: Derisa ne jemi krenarë me xhudon kosovare, sportet e

tjera duhet të ngrehen sepse xhudo po i fiton të gjitha çmimet çdo vit dhe, edhe pse i meriton ato, ne nuk duam të quhemi ngacmues. Gjithashtu, Driton Kuka u kthye në shtëpi me çmimin e trajnerit të vitit. Ne jemi të sigurt se ai nuk ka hapësira të shumta në shtëpinë e tij pasi këtë çmim e fiton çdo vit", shkruan Federata Ndërkombëtare e Xhudos në uebfaqen zyrtare.



Gashi, 'ylli i javës' në Superligë



PRISHTINË, 7 MARS - Federata e Futbollit e Kosovës, së bashku me sponsoren e Superligës, Bankën Kombëtare Tregtare, BKT Kosova, vazhdojnë ta japin çmimin "ylli i javës" për lojtarin më të mirë të xhiros. "Ylli i javës" për xhiron e 23-të në BKT Superligë është shpallur futbollisti i KF

Drenica, Lumi Gashi. Mesfushori qendror i kuqezinjve ishte lojtari më i mirë i ndeshjes në fitoren e rëndësishme që skuadra e tij e arriti në shtëpi ndaj Dritës me rezultat 2:1. Ai shënoi eurogol në këtë ndeshje duke zhbllokuar rezultatin për fitoren e parë pas pesë vjetëve në përballje me

ekipin e Dritës. Fitorja e kësaj jave ia ka mundësuar skuadrës kuqezi nga Skenderaj ta përforcojë pozitën e pestë në renditje në elitën e futbollit të Kosovës me 31 pikë. Çmimin "ylli i javës" për futbollistin e FC Drenica e dha Erand Elmazi, senior specialist në BKT.

Berisha debuton në Serinë A: Jam i lumtur që jam pjesë e Torinos

Torino, 7 mars - Etrit Berisha ka debutuar në Serinë A me fanellën e Torinos. Portieri i Kombëtares së Shqipërisë ka qëndruar në fushë për gjatë 90 minutave në barazimin e Torinos në udhëtim te Bologna. Paraqitja e Berishës është vlerësuar lart në mediet italiane, me portierin prishtinas që mbajti portën e

paprekur. 32-vjeçari bëri disa pritje fantastike duke i treguar edhe trajnerit kroat Juriq se meriton fanellën e titullarit. "Bëmë ndeshje që duhej ta bënim por që, fatkeqësisht, nuk arritëm të shënonim gol. Në fund duhet të pranojmë pikën e fituar dhe të shohim përpara. Ka ende edhe shumë ndeshje

për t'u zhvilluar", ka thënë Berisha. Ai foli edhe për paraqitjen e tij duke thënë se është i lumtur që është pjesë e Torinos. "Jemi 25 futbollistë që luftojmë gjithmonë. Në fushë u mundova ta ndihmoj skuadrën dhe të jem gati. Jam i lumtur që jam pjesë e kësaj skuadre", u shpreh portieri prishtinas.



Putini përjashtohet nga Federata Ndërkombëtare e Xhudos





BUDAPEST, 7 MARS - Presidenti rus Vladimir Putin dhe oligarku Arkady Rotenberg janë shkarkuar nga të gjitha pozitat e tyre në Federatën Ndërkombëtare të Xhudos (IJF) ka thënë organi drejtues i sportit në një deklaratë të dielën, raporton CNN. Vendimi vjen pasi IJF njoftoi se e ka pezulluar rolin e Putinit si president nderi muajin e kaluar për shkak të

konfliktit të vazhdueshëm në Ukrainë. Federata Ndërkombëtare e Xhudos njofton se "Vladimir Putin dhe Arkady Rotenberg janë larguar nga të gjitha pozicionet e mbajtura në Federatën Ndërkombëtare të Xhudos", thuhet në deklaratën e fundit. IJF është një nga një sërë organesh qeverisëse që i kanë hequr Putinit titujt e nderit sportiv që nga

shpërthimi i luftës. Federata e Taekwondos ia hoqi Putinit rripin e zi të nderit që ia kishte dhënë në nëntor 2013, ndërsa Federata Ndërkombëtare e Notit (FINA) ia hoqi Urdhrin e FINA-s që ia kishte dhënë më parë presidentit rus në tetor 2014. Rotenberg, ndërkohë, kishte qenë anëtar i komitetit ekzekutiv të IJF-së si menaxher zhvillimi që nga viti 2013.

PROTESTË!

*Proteston, refuzon, mallkon, pena e shkrimtarit:
Kur burgosen çlirimtarët, burgoset edhe
populli!
Kur burgoset UÇK-ja, burgoset edhe liria!*

**“Hero në luftë, Hero në paqe” – 1****“Drenica para gjyqit” – 2****“UÇK-ja para gjyqit” – 3****“Na e ban hallall, Kosove” – 4****“Edhe malet janë Kosova para gjyqit,
UÇK - 5****Murtoja e Kuqe-7
dramë, 6**

(Këta janë 7 libra publicistikë, të botuar nga Riza Greiçevci për Gjykatën Speciale të Hagës, ku po gjykohen: UÇK-ja, çlirimtarët, Drenica, liria, dëshmorët, pushka e Adem Jasharit, Kosova...!)



Bazuar në dispozitat 38.3 dhe 38.4 të Ligjit për Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës, Banka Qendrore e Republikës së Kosovës (BQK) shpall:

KONKURS për Zëvendësguvernator

BQK është institucion i pavarur i themeluar me ligj të veçantë, ndërsa funksionet e saja kryesore janë: të sigurojë sistem financiar të qëndrueshëm; të rregullojë, licencojë dhe mbikëqyrë institucionet financiare; të mirëmbajë sistem të pagesave të sigurt dhe efikas; të kontribuojë në stabilitetin e çmimeve; të menaxhojë rezervat ndërkombëtare të vendit; të veprojë si bankier, agjent fiskal dhe këshilltar financiar për Qeverinë dhe entitetet e tjera publike; të kryejë analiza ekonomike dhe prodhojë statistika monetare-financiare dhe të bilancit të pagesave.

Krahas plotësimit të kriterëve të përcaktuara me nenet 40 dhe 41 të Ligjit për BQK-në, të gjithë kandidatët duhet t'i njohin politikat dhe aktivitetet me rëndësi ndërlidhur me misionin, objektivat dhe kompetencat e BQK-së, të kenë përvojë të theksuar në vendimmarrje dhe në menaxhimin e burimeve njerëzore dhe të proceseve, të posedojnë veçori personale që reflektojnë integritet dhe reputacion të lartë, si dhe të demonstrojnë aftësi të shkëlqyeshme ndërpersonale dhe komunikuese.

Zëvendësguvernatori ndihmon Guvernatorin në realizimin e detyrave të tij dhe të njëjtit i delegohen detyra specifike nga ana e Guvernatorit.

Të gjithë kandidatët duhet t'i parashtrajnë dokumentet e mëposhtme:

- Formularin zyrtar të BQK-së për aplikim;
- Letrën përcjellëse (motivuese) ku theksohet interesimi për këtë pozitë;
- Dëshmi mbi identitetin dhe vendbanimin e përhershëm në Kosovë;

Procedura e aplikimit:

- Afati i fundit për aplikim është 21 mars 2022.
- Aplikimi mund të bëhet përmes postës elektronike paneli@bqk-kos.org ose përmes Arkivit të BQK-së, rr. Garibaldi nr. 33.
- Formën e aplikacionit mund ta shkarkoni përmes ueb-faqes: www.bqk-kos.org
- Vetëm kandidatët e përzgjedhur nga ana e panelit do të thirren në intervistë.

NJOFTIM

Njoftojmë të gjithë klientët se MOBILERIA “TE DULI” SH.P.K. ka marrë vendim të shuajë biznesin me nr. 811473321, me pronar Edon Hyseni dhe Emin Hyseni dhe ka caktuar likuidatorin për zhvillimin e procedurës së Likuidimit. Njoftohen të gjithë klientët që kanë raporte Kreditore - Debitorë në këtë korporatë që të paraqiten në afatin 30 ditor nga data e shpalljes në gazetë.

OBAVESTENJE

Obavestavanje se svi klienti da drustvo sa MOBILERIA “TE DULI” D.O.O. donelo odluku o prestani rada sa nr. 811473321 sa vlasnikom Edon Hyseni dhe Emin Hyseni, ujedno imenovao Likvidatora o sprovođenju postupka likfidacije. Obavestavaju se svi klienti koji imaju obaveze i potraživanja u navedenoj firmi, da se jave u roku od 30 dana od dana objavljivanja o novine.

ANNOUNCEMENT

All clients are to be informed that the MOBILERIA “TE DULI” L.L.C. has come to the decision to quit its business: nr. 811473321, Edon Hyseni the Emin Hyseni the company has appointed a liquidator who is going to oversee the liquidator process. All clients who have the mortgager – mortgage accounts in this company are kindly request to show up within 30 days starting from the day of newspaper announcement- publication.



Na osnovu člana 38.3 i 38.4 Zakona o Centralnoj banci Republike Kosova, Centralna banka Republike Kosovo (CBK) raspisuje:

KONKURS za Zamenika guvernera

CBK je nezavisna institucija osnovana posebnim zakonom, dok njene glavne funkcije su: obezbeđivanje stabilnog finansijskog sistema; reguliše, licencira i nadzire finansijske institucije; održava siguran i efikasan platni sistem; doprinosi stabilnosti cena; upravlja međunarodnim rezervama zemlje; deluje kao bankar, fiskalni agent i finansijski savetnik za Vladu i druge javne entitete; sprovodi ekonomsku analizu i izrađuje monetarnu-finansijsku statistiku i platni bilans.

Pored ispunjavanja kriterijuma utvrđenih članovima 40. i 41. Zakona o Centralnoj banci Republike Kosova, svi kandidati moraju ispuniti i druge dodatne kriterijume vezane za poznavanje politika i aktivnosti od značaja u vezi sa misijom, ciljevima i nadležnostima CBK-a, imaju značajno iskustvo u donošenju odluka, upravljanje ljudskim resursima i procesima, poseduju lične osobine koje odražavaju integritet i visoku reputaciju, kao i da demonstriraju odlične međuljudske i komunikativne sposobnosti.

Zamenik guvernera pomaže guverneru u obavljanju svojih dužnosti i istom se delegiraju specifični zadaci od strane guvernera.

Svi kandidati treba da dostave sledeće dokumente:

- Zvanični obrazac CBK –a za apliciranje;
- Prateće (motivaciono) pismo gde se naglašava interesovanje za ovu poziciju;
- Dokaz o identitetu i stalnom boravku na Kosovu;

Procedura apliciranja:

- Krajnji rok za apliciranje je 21. marta 2022.
- Aplikacija može biti poslata elektronskom poštom paneli@bqk-kos.org ili putem arhive CBK-a, ul. Garibaldi br. 33.
- Obrazac za apliciranje možete preuzeti putem veb stranice: www.bqk-kos.org
- Samo kandidati odabrani od strane panela biće pozvani na intervju.

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

- ▶ “Eev Group” SH.P.K. me nr. Unik Identifikues: 810802985 Prishtinë, shtet aparatit për estetik, me çmim të volitshëm, aparati është “Viophos Hifu Face”. Numri kontaktues 049-299-500.
- ▶ Muhamet Ponik shpall të pavlefshme dëftesat e kp I - IX shfmu " Mic Sokoli " Lubeqev.
- ▶ Ardit Sejfullahu shpall të pavlefshme dëftesat e kl I - IX shfmu " Bajram Curri " Krush e Madhe.
- ▶ Petrit Sejfullahu shpall te pavlefshme dëftesat e kl I - IX shfmu " Bajram Curri " Krush e Madhe.
- ▶ Edon Arifi shpall të pavlefshme certifikatën e shkollës Junarodni Universitet Vranje.
- ▶ Egzon Arifi shpall të pavlefshme certifikatën e shkollës Junarodni Universitet Vranje.
- ▶ Auto shkolla “Baza-L” Gjilan, për nder të 7 dhe 8 marsit ofron zbritje në regjistrimin e kandidatëve, çmimi 100 Euro, oferta vlen prej datës 7-10 mars 2022.
- ▶ Veli Kryeziu Gjakovë shpall të pavlefshme certifikatën për electricist të lëshuar nga Q.A.P. në Gjakovë.
- ▶ Lëshoj banës me qira në lagjen “Dardania” në Prishtinë. Banesa ka 50 m2, me inventar të kompletuar, banesa ka kuzhinë me sallon, teras, banjo një dhomë gjumi, shpajz dhe korridor, banesa lëshohet për një qift ose për dy vajza. Tel: 044171328.
- ▶ Lëshoj shtëpinë me qira në lagjen Velania, pa pagesë sepse shtëpia ka nevojë për përkujdesje ndërsa shpenzimet mujore ti bëjë vetë banuesi si: ujë rrym bërlllok, Tel: 044-608-626.
- ▶ Lëshoj banës me qira për student apo familjar në lagjen "Mati 1" Rr. "Muharrem Fejza", banesa është 70 m2 dhe i plotëson të gjitha kushtet, kati dytë ndërtim i ri tel: 044-686-900.
- ▶ Lëshoj banesë me qira, banesa është ndërtim i ri dhe gjendet në lagjen "Mati 1" rruga "Muharrem Fejza" Prishtinë. Tel: 044-686-900.
- ▶ Lëshoj banesë me qira në lagjen "Mati 1" përball "Super Vivës", me sipërfaqe mbi 50 m2, kati dytë me ngrohje, klimë, ashensorë etj, çmimi 200 Euro. Tel: 044-185-233.
- ▶ Lëshoj banesë me qira garsoniere në Ulpian kati i parë, posedon tre shtretër dhe e mobiluar. Preferohet për studenta ose studente, një qift apo të tjerë. Çmimi është 185 euro. Tel: 044-812-875.



ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales

